

**NIPT: K 01410001 N**

# PASQYRAT FINANCIARE VITI 2015


**Hartuesi**

Luiza Korbi



**Administratori**

Sagest Ekonomi



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk  
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	63,062,994	22,224,781
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	17,917,339	8,519,309
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	362,972	136,860
Inventarë	7	313,123	313,123
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		<b>81,656,428</b>	<b>31,194,073</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	11,531,269	10,098,368
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,541,417	1,871,721
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>13,072,686</b>	<b>11,970,089</b>
<b>Total aktive</b>		<b>94,729,114</b>	<b>43,164,162</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	10	5,161,327	1,159,393
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	-	18,216,058
Detyrime tatimore	12	13,934,615	3,739,947
Të ardhurat e shtyra	13	20,281,131	1,927,350
Parapagime të marra	14	403,625	-
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>		<b>39,780,698</b>	<b>25,042,748</b>
Detyrime afatgjata		-	-
<b>Total detyrime afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>39,780,698</b>	<b>25,042,748</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar		8,903,000	8,903,000
Rezerva ligjore		1,224,000	1,224,000
Rezerva statutore		200,000	200,000
Fitimi i ushtrimit		44,621,416	7,794,414
<b>Total kapitali</b>	15	<b>54,948,416</b>	<b>18,121,414</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>94,729,114</b>	<b>43,164,162</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk  
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	173,800,631	73,443,366
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(314,061)	(26,797)
<b>Lënda e parë, shërbime dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>(40,907,861)</b>	<b>(21,605,455)</b>
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	18	(27,794,914)	(14,202,343)
2) Të tjera shpenzime	19	(13,112,947)	(7,403,112)
<b>Shpenzime të personelit</b>	20	<b>(77,301,722)</b>	<b>(38,734,596)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(71,180,745)	(33,966,593)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(6,120,977)	(4,768,003)
Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(2,509,025)	(2,404,332)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(30,000)	(3,520)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra	22	71,448	(1,235,765)
<b>Shpenzime financiare</b>	23	<b>6,145</b>	<b>11,390</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		6,145	11,390
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>52,815,555</b>	<b>9,444,291</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(8,194,139)</b>	<b>(1,649,877)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	24	(8,194,139)	(1,649,877)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>44,621,416</b>	<b>7,794,414</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		<b>44,621,416</b>	<b>7,794,414</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Instituti i Modelimeve në Biznes shpk**  
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore dhe Statutore	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni më 1 janar 2014</b>	<b>38,903,000</b>	<b>1,424,000</b>	<b>4,632,300</b>	<b>44,959,300</b>
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Zvogelim i kapitalit themeltar	(30,000,000)		7,794,414	7,794,414
Dividendë të paguar			(4,632,300)	(30,000,000)
				(4,632,300)
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2014</b>	<b>8,903,000</b>	<b>1,424,000</b>	<b>7,794,414</b>	<b>18,121,414</b>
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Dividendë të paguar			44,621,416	44,621,416
			(7,794,414)	(7,794,414)
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2015</b>	<b>8,903,000</b>	<b>1,424,000</b>	<b>44,621,416</b>	<b>54,948,416</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Instituti i Modelimeve në Biznes sh.p.k më \_\_\_\_\_ dhe janë firmosur si më poshtë.



*Sagëst Ekonomik*  
**Sagëst Ekonomik**  
**Administrator**

*Luiza Korbi*  
**Luiza Korbi**  
**Financiere**

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitim / Humbja e vitit</b>	<b>44,621,416</b>	<b>7,794,414</b>
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	315,970	22,303
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	6,706,280	534,241
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,509,025	2,404,332
Krijimi/rimarrja e provizioneve	(71,448)	1,235,765
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Humbje nga nxerrja nga përdorimi i AAM-ve	133,666	173,397
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(9,552,694)	15,657,819
Rënie/(rritje) në inventarë	-	75,927
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	8,031,670	21,761,780
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>52,693,885</b>	<b>49,659,978</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(3,745,288)	(4,402,626)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(3,745,288)</b>	<b>(4,402,626)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Zvogelim kapitali		(30,000,000)
Dividendë të paguar	(7,794,414)	(4,632,300)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>(7,794,414)</b>	<b>(34,632,300)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>41,154,183</b>	<b>10,625,052</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	22,224,781	11,622,032
Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(315,970)	(22,303)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>63,062,994</b>	<b>22,224,781</b>

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Instituti i Modelimeve në Biznes shpk" është krijuar në vitin 1997, me vendim gjykate Nr. 17769 datë 23/09/1997. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare"

Instituti i Modelimeve në Biznes shpk është një shoqëri shqiptare me adresë të regjistruar në Bulevardin "Gjergj Fishta", P. Pallati Nr.4, Ap.42, 45, 47 dhe 2/2, Tiranë. Shoqëria ka NIPT K01410001N.

Ortakët e shoqërisë janë:

• Kelvin Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Kosta Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Sagest Ekonomi	15% ose	1,335.45 pjesë të kapitalit
• Maksi Raco	55% ose	4,896.65 pjesë të kapitalit.

Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë paraqitet në vlerën 8,903,000 ALL.

Objekti i shoqërisë është në fushën informatike, import- export dhe shitje me shumicë e pakicë të pajisjeve informatike e elektronike të ndryshme.

Më 31 dhjetor 2015 shoqëria ka 63 punonjës (2014: 46).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.





### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

##### *Kapitali*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje zyre e informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë aktiviteti amortizohet plotësisht.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### 3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 3.10. Transaksionet me palët e lidhura


Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### 3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



A handwritten signature in blue ink is located at the bottom right of the page, to the right of the stamp.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	60,733,659	14,053,312
Mjete monetare në arkë	2,329,335	8,171,469
	<u><u>63,062,994</u></u>	<u><u>22,224,781</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë për mallra, produkte e shërbime	17,917,339	9,755,074
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	-	(1,235,765)
	<u><u>17,917,339</u></u>	<u><u>8,519,309</u></u>
Gjendje më 1 janar	1,235,765	-
Shtesa	-	1,235,765
Pakësime	(1,235,765)	-
	<u><u>-</u></u>	<u><u>1,235,765</u></u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	48,100	-
Parapagime	52,012	-
Garanci	262,860	136,860
	<u><u>362,972</u></u>	<u><u>136,860</u></u>

7. Inventari

Shoqëria ka kryer inventarizimin e gjendjeve të inventarit në fund të vitit, rezultatet e të cilit përputhen me vlerën e stokut të pasqyruar në bilanc. Në mbyllje të vitit ushtrimor janë kryer llogaritjet e sakta për pasqyrimin në rezultatit e ushtrimit të efekteve të ndryshimit të gjendjeve të inventarit. Kontabilizimi i veprimeve me stokun kryhet konform normave kontabël.

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mallra	313,123	313,122
	<u><u>313,123</u></u>	<u><u>313,123</u></u>



Instituti i Modelimeve në Biznes shpk  
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015  
(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive afatgjata materiale

	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Gjendja më 1 janar 2014	2,908,277	3,891,147	7,392,495	11,301,731	25,493,650
Shtesa			1,720,833	479,768	2,200,601
Nxjerrje jashtë përdorimit			(989,522)	(1,573,344)	(2,562,866)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>2,908,277</b>	<b>3,891,147</b>	<b>8,123,806</b>	<b>10,208,155</b>	<b>25,131,385</b>
Shtesa	592,568		1,734,764	1,417,956	3,745,288
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,114,554)		(366,280)	(1,145,553)	(2,626,387)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,386,291</b>	<b>3,891,147</b>	<b>9,492,290</b>	<b>10,480,558</b>	<b>26,250,286</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2014	1,977,431	1,778,611	4,627,497	6,964,919	15,348,458
Amortizimi i vitit	186,169	422,507	951,049	514,303	2,074,028
Nxjerrje jashtë përdorimit			(901,277)	(1,488,192)	(2,389,469)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>2,163,600</b>	<b>2,201,118</b>	<b>4,677,269</b>	<b>5,991,030</b>	<b>15,033,017</b>
Amortizimi i vitit	187,793	338,006	1,064,567	588,355	2,178,721
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,052,664)		(340,542)	(1,099,515)	(2,492,721)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,298,729</b>	<b>2,539,124</b>	<b>5,401,294</b>	<b>5,479,870</b>	<b>14,719,017</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	744,677	1,690,029	3,446,537	4,217,125	10,098,368
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,087,562	1,352,023	4,090,996	5,000,688	11,531,269



9. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM
<b>Me kosto</b>	
Gjendja më 1 janar 2014	-
Shtesa	2,202,025
Pakësime	
Gjendja më 31 dhjetor 2014	<u>2,202,025</u>
Shtesa	-
Pakësime	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	<u><u>2,202,025</u></u>
<b>Amortizimi</b>	
Gjendja më 1 janar 2014	
Shtesa	330,304
Pakësime	
Gjendja më 31 dhjetor 2014	<u>330,304</u>
Amortizimi i vitit	330,304
Kthim amortizimi	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	<u><u>660,608</u></u>
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2014</b>	<u>1,871,721</u>
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2015</b>	<u><u>1,541,417</u></u>

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorë	5,161,327	1,101,061
Furnitorë për fatura të pambërritura	-	58,332
	<u>5,161,327</u>	<u>1,159,393</u>

Llogaritë e pagueshme tregtare pasqyrojnë detyrimet për blerjen e materialeve dhe shërbimeve. Shoqëria ka mbajtur evidencë analitike për çdo furnitor.

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve të shoqërisë	-	18,216,058
	<u>-</u>	<u>18,216,058</u>



12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Sigurimet shoqërore	1,108,305	718,505
Tatim në burim	322,351	-
Tatim mbi të ardhurat personale te punonjësve	5,757,370	268,314
Tatimi mbi fitimin	6,706,280	329,705
TVSH e pagueshme	40,309	2,423,423
	<b>13,934,615</b>	<b>3,739,947</b>

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura të shtyra	20,281,131	1,927,350
	<b>20,281,131</b>	<b>1,927,350</b>


14. Parapagime të marra

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime të marra	403,625	-
	<b>403,625</b>	<b>-</b>

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 8.903.000 Lek (8,903 kuota me 1,000 Lek vlere nominale).

	31 dhjetor 2015			31 dhjetor 2014		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Kelvin Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	890,300	10%
Kosta Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	2,225,750	25%
Sagest Ekonomi	1,335.45	1,335,450	15%	1,335.45	890,300	10%
Maksi Raço	4,896.65	4,896,650	55%	4,896.65	4,896,650	55%
	<b>8,903.00</b>	<b>8,903,000</b>	<b>100%</b>	<b>8,903.00</b>	<b>8,903,000</b>	<b>100%</b>



Handwritten signature in blue ink.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	68,903,593	36,538,648
Të ardhura nga shitja e produkteve	103,618,776	36,722,419
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,278,262	182,299
	<u>173,800,631</u>	<u>73,443,366</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
<b>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</b>	<b>193,534,504</b>	<b>82,375,214</b>
Qarkullim i tatueshëm		
Zbriten Autofaturimet 2015	(1,689,465)	(6,291,500)
Zbriten paradhëniet	(403,625)	
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2014	1,927,350	(1,927,350)
Zbriten të ardhura të shtyra për 2015	(20,281,131)	
Shitje të 2014 që janë anuluar dhe deklaruar me minus në librat e vitit 2015	712,998	(712,998)
Shtohen diferencat e kembimit të përfshira në zerin		
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	(314,061)	(26,797)
<b>Shuma e qarkullimit të korrigjuar</b>	<b>173,486,570</b>	<b>73,416,569</b>
Sipas Kontabilitetit	173,486,570	73,416,569
Diferenca	-	-

Për vitin e mbyllur  
më 31 dhjetor 2015

Të ardhura sipas kontabilitetit	173,486,570
Shtohen humbjet e këmbimit të përfshira në të ardhura të tjera	330,977
Të ardhura nga interesat përfshirë në të ardhura financiare	6,145
Të ardhura nga grantet paraqitur neto në shpenzime	1,400,000
Për t'u deklaruar në FDP tatim fitimi	175,223,692



*[Handwritten signature]*



17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitime nga këmbimet valutore	16,916	15,933
Humbje nga këmbimet valutore	(330,977)	(42,730)
	<b>(314,061)</b>	<b>(26,797)</b>

18. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Materiale të para	18,132,989	1,639,077
Mallra dhe programe	593,558	205,792
Shërbime	9,068,367	12,357,474
Blerje programesh	1,446,691	937,986
Energji elektrike e shpenzime komunikimi	4,359,981	4,747,461
Nëntrajnime e programe të tjera	510,163	1,352,699
Mirëmbajtje e riparime nga të tretë	387,301	435,844
Shërbime nga të tretë	1,945,642	-
Kuota pjesë e shpenzimeve për t'u shpërndarë	-	4,089,475
Të tjera	418,589	794,009
	<b>27,794,914</b>	<b>14,202,343</b>



19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Qira zyre	4,455,683	3,546,643
Taksa lokale e të tjera	57,773	47,920
Reklama	551,890	326,913
Transferime, udhëtime e dieta	1,212,928	880,269
Shërbime bankare	185,021	178,645
Dieta tej kufirit të lejuar	157,623	97,560
Shpenzime për pritje e përfaqësime	137,268	298,078
Shpenzime te panjohura	1,084,718	140,296
Blerje uji e materiale sanitare	710,367	554,550
AQT- jashtë përdorimit	133,665	173,397
Honorare	1,041,469	85,850
Shpenzime per certifikim ISO	516,667	-
Shpenzime të tjera	2,867,875	1,072,991
	<b>13,112,947</b>	<b>7,403,112</b>

Shoqëria gjatë vitit 2015 ka përfituar një grant nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit dhe investimeve për shumën 1,400,000 Lek në kuadër të programit "Fondi Shqiptar i konkureshmërisë" me donator Qeverinë shqiptare. Ky grant i është dhënë shoqërisë për të financuar certifikimin dhe konsulencën ISO 9001:2008 dhe certifikim dhe konsulencë ISO 27001. Shoqëria i ka plotësuar të gjitha kushtet e paracaktuara në marrëveshjen e grantit.

Të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me objektin e grantit janë paraqitur neto në zërin "Shpenzime për certifikim ISO" dhe janë përfshirë në zërin "Të tjera shpenzime nga aktiviteti i shfrytëzimit" në pasqyrën e performancës.

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	71,180,745	33,966,593
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	6,120,977	4,768,003
	<b>77,301,722</b>	<b>38,734,596</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 63 (2014: 46).



21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoha dhe penalitete	30,000	3,520
	<b>30,000</b>	<b>3,520</b>

22. Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Zhvlerësim i kërkesave për arkëtim/(rimarrje)	(1,235,765)	1,235,765
Shpenzime borxh i keq	1,164,317	-
	<b>(71,448)</b>	<b>1,235,765</b>

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interes	6,145	11,390
	<b>6,145</b>	<b>11,390</b>

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	<b>52,815,555</b>	<b>9,444,291</b>
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	1,812,039	1,554,889
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	30,000	3,520
Shpenzime udhëtimi	157,623	97,560
Tatim i panjohur	254,415	-
Shpenzime pritje & percjellje	-	77,748
Debitor të keqinj (Humbje nga mosarkëtimi)	1,164,317	-
Provizion për zhvlerësime	(1,235,765)	1,235,765
Shpenzime të tjera	1,441,449	140,296
<b>Fitimi i tatueshëm për periudhën</b>	<b>54,627,594</b>	<b>10,999,180</b>
Norma e tatim fitimit (15%)		
<b>Shpenzime për tatim fitimin</b>	<b>8,194,139</b>	<b>1,649,877</b>



24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatim fitimi më 1 janar	(329,705)	204,536
Paguar detyrimi i vitit paraardhës	329,705	-
Parapagime tatim fitimi	1,487,859	1,115,636
Shpenzime tatim fitimi	(8,194,139)	(1,649,877)
Tatim fitimi i parapaguar/(për t'u paguar)	<u>(6,706,280)</u>	<u>(329,705)</u>

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Përfitimet e stafit drejtues	24,667,117	6,982,280
	<u>24,667,117</u>	<u>6,982,280</u>

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

